



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës Opština Podujevo Municipality of Podujeva

KUVENDI

Në bazë të neneve 12.2, shkronja c dhe 17 shkronja f të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nr. 03/L-040, neneve 15 dhe 34 të Ligjit për mbeturina, nr. 04/L – 60, neneve 15.2 shkronja c dhe 19 shkronja f të Statutit të Komunës së Podujevës nr. 01-1/298-10, Kuvendi i Komunës së Podujevës në mbledhjen e mbajtur më 4 shkurt 2015 miratoi,

RREGULLORE PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË PODUJEVËS

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Qëllimi

Neni 1

Më këtë Rregullore përcaktohet orari, sistemi dhe kushtet për mënyrën e mbledhjes, ndarjes, përpunimit dhe riciklimit të mbeturinave, llojin, numrin dhe mënyrën e shpërndarjes dhe vendosjes së kontejnerëve, mirëmbajtja e vendeve ku grumbullohen ato dhe mënyrën e transportimit.

II. PËRGJEGJËSITË DHE DETYRAT E KOMUNËS

Përgjegjësitë e Komunës

Neni 2

Përgjegjësitë dhe detyrat e Komunës, të parapara me Ligjin për mbeturina, në këtë rregullore janë:

- 2.1 Hartimi i planit lokal të veprimit për menaxhimin e mbeturinave
- 2.2 Hartimi i raportit vjetor për menaxhimin e mbeturinave
- 2.3 Rregullimi i përgjegjësisë dhe detyrave për kryerjen e shërbimeve
- 2.4 Informimi i publikut
- 2.5 Zbatimi i procedurës së prokurimit për përzgjedhjen e operatorit për mbeturina
- 2.6 Caktimi i tarifave dhe mënyra e arkëtimit të mjeteve financiare
- 2.7 Mbikëqyrja e menaxhimit të mbeturinave
- 2.8 Dhënia e informatave dhe rekomandimeve dhe
- 2.9 Lidhja e marrëveshjeve me komunat tjera për menaxhimin e mbeturinave.

Llojet e mbeturinave

Neni 3

Sipas kësaj Rregulloreje, mbeturina komunale konsiderohen:

3.1 Mbeturina inerte, që nuk tretën, nuk ndizen dhe nuk kanë si pasojë reagime fizike ose kimike, që nuk kanë zbërthim biologjik në kontakt me materiet tjera dhe nuk ndikojnë në mënyrë të ndjeshme në mjedisin dhe shëndetin e njeriut.

3.2 Mbeturina të parrezikshme, që nuk paraqesin rrezik për mjedisin dhe shëndetin e njeriut dhe nuk kanë karakteristika të mbeturinave të rrezikshme.

3.3 Mbeturina të vëllimshme, mbeturina me përmasa të mëdha fizike nga pajisjet dhe makineritë.

3.4 Mbeturina nga konstruktiv-demolimet, mbeturina të mbetura nga konstruktivi dhe demolimi i objekteve.

Plani i veprimit

Neni 4

Plani i Veprimit të Komunës duhet të jetë në pajtim me Planin e Republikës së Kosovës për menaxhimin e mbeturinave të nxjerra nga Ministria, me pjesët e përshkruara në dispozitat e nenit 10 të Ligjit përkatës.

Menaxhimi i mbeturinave

Neni 5

5.1 Të gjitha subjektet, të cilat, në përputhje me natyrën e veprimtarisë së tyre, krijojnë lloje të ndryshme mbeturinash, duhet të bëjnë ndarjen e tyre.

5.2 Çerdhet dhe shkollat, institucionet e arsimit të lartë që veprimtarinë e tyre e ushtrojnë në territorin e komunës, duhet të edukojnë nxënësit - studentët në përputhje me rregullat bashkëkohore të trajtimit të mbeturinave.

5.3 Shoqëritë që ofrojnë shërbime tregtare, hoteliere dhe shërbime tjera, kanë për obligim të mbajnë mjedisin e pastër përreth objekteve, përfshirë edhe trotuarin para objektit.

5.4 Të gjithë krijuesit e mbeturinave janë të obliguar të regjistrohen në listat e shërbimit të konsumatorëve për mbledhje dhe bartjen e mbeturinave.

Shportat dhe kontejnerët e mbeturinave

Neni 6

6.1 Komuna përcakton llojin, vëllimin, numrin, vendin dhe qëllimin e vendosjes së kontejnerëve të mbeturinave, si dhe periudhën kohore të mbledhjes së tyre.

6.2 Për mbledhjen dhe ndarjen e mbeturinave përdoren kontejnerë dhe shporta, si në vijim:

Madhësia e kontejnerit pesha maksimale e lejuar lloji i mbeturinave

- a) 1.1 m³ dhe 3.2 m³ (kontejnerë nëntokësor dhe mbitokësor) 440 kg – 1320 kg mbeturina të amvisërisë
- b) 5 m³, 4000 kg mbeturina inerte
- c) 7 m³, 6000 kg mbeturina të vëllimshme

Madhësia e shportave për mbeturina të amvisërisë, përcaktuar në litër:

- a) 60 l
- b) 80 l
- c) 120 l

6.3 Shtëpitë dhe lokalet afariste duhet pasur së paku një (1) shportë për hedhjen e mbeturinave.

- a) Bizneset e mëdha duhet të kenë kontejnerë përkatës
- b) Me krijimin e kushteve për riciklimin e mbeturinave shtëpitë, lokalet afariste dhe bizneset e mëdha duhet të kenë së paku dy (2) shporta / kontejnerë për hedhjen e mbeturinave të ndara.
- c) Në trotuare, sheshe dhe parqe vendosen shporta dhe kontejnerë sipas nevojës

6.4 Numri i kontejnerëve duhet të përshtatet me numrin e banorëve në objektet e përbashkëta të banimit dhe llojin e mbeturinave që krijojnë. Hedhja e mbeturinave shtëpiake nga personat e objekteve të banimit kolektiv, bëhet në kontejnerët apo në vendet për mbledhjen dhe ndarjen e mbeturinave.

6.5 Spitalet, ambulancat dhe objektet tjera për shërbime mjekësore, duhet të përdorin sistemin e ndarë të kontejnerëve, me qëllim të ndarjes së mbeturinave medicinale dhe mbeturinave të tjera.

6.6 Qytetarët duhet të jenë të informuar mbi llojin e kontejnerëve të ofruar nga Komuna, në bashkëpunim me operatorë. Njëri kontejner shërben për hedhjen e mbeturinave organike, ndërsa kontejneri tjetër shërben për mbeturina tjera të riciklueshme.

Neni 7

7.1 Kontejnerët për hedhjen e mbeturinave duhet të vendosen në vende të dukshme dhe të përshtatshme, ku nuk shkaktojnë pengesë apo rrezik për lëvizjen e lirë të qytetarëve dhe qarkullimin e mallrave.

7.2 Kontejnerët duhet të kenë ngjyra të ndryshme ose mbishkrime të dukshme që udhëzojnë për klasifikimin e mbeturinave.

7.3 Kontejnerët në masën deri 1.1 m³ duhet të kenë mekanizëm mbyllës, dhe ata për ndarje kapak në kapak.

7.4 Kontejnerët duhet të kenë sipërfaqe të lëmuar, që mund të pastrohen lehtësisht dhe materiali i tyre (metal, plastikë etj.) duhet të jetë i qëndrueshëm dhe i papërshkueshëm nga uji.

7.5 Kontejnerët për mbeturina duhet të jenë teknikisht të përshtatshëm për automjetet që bëjnë zbrazjen e mbeturinave.

7.6 Lokacionet për vendosjen e kontejnerëve i cakton Komuna, në përputhje me planet rregulluese.

7.7 Kontejnerët dhe shportat e mbeturinave lejohen në përdorim nga ana e Komunës, në përputhje me kërkesën e operatorit ose e palëve të treta të kontraktuara.

7.8 Orarin dhe dinamikën e mbledhjes së mbeturinave e përcakton Komuna, në bashkëpunim me operatorin.

7.9 Komuna, sipas nevojës, autorizon operatorin që të bëjë mbledhjen e mbeturinave edhe jashtë orarit dhe dinamikës së paraparë.

7.10. Operatori, në bazë të marrëveshjes me Komunën, vendos numrin e nevojshëm të kontejnerëve në hapësirat e objekteve të përbashkëta banimit.

7.11 Komuna përcakton llojin e kontejnerëve të përshtatshëm me teknikën me të cilën bëhet mbledhja, ndarja dhe transportimi i tyre.

Skema organizative dhe zona e shërbimit të menaxhimit të mbeturinave

Neni 8

8.1 Komunitat miratojnë dhe publikojnë skemën organizative me strukturë dhe përmasë të shërbimit për mbledhjen dhe ndarjen e mbeturinave për çdo vendbanim, lagje apo hapësirë ose sipërfaqe publike.

8.2 Mbledhja dhe ndarja (klasifikimi) e mbeturinave nëpër rrugë, sheshe, trotuare dhe hapësira ose vende brenda qytetit, duhet të bëhet:

Në pjesën urbane prej orës 22:00 deri në orën 08:00 të mëngjesit, kurse në periferi të qytetit dhe në fshatra edhe gjatë ditës.

8.3, Pastërtia brenda qytetit sigurohet gjatë ditës, duke grumbulluar dhe larguar mbeturinat nga sheshet, rrugët, trotuaret dhe hapësirat tjera.

8.4. Mbledhja dhe ndarja e mbeturinave nga rrugët, sheshet, trotuaret dhe hapësirat ose sipërfaqet tjera në vendbanimet rurale ku janë të vendosur kontejnerët me mbeturina, duhet të kryhet brenda 24 orësh sipas orarit të caktuar.

8.7 Kriteret për përcaktimin e zonave, sipas paragrafit 6 të këtij neni, i cakton Komuna.

Pikat mbledhëse për mbeturinat e vëllimshme

Neni 9

9.1 Komuna bënë zgjedhjen dhe caktimin e vendeve pikave grumbulluese të mbeturinave caktimin e hapësirave për ndërtim të qendrave më të mëdha për grumbullimin e tyre në vendbanimet periferike të qytetit apo edhe ato rurale.

9.2 Caktohen pikat grumbulluese të mbeturinave sipas planit rregullues.

9.3 Pika mbledhëse për mbledhje të mbeturinave duhet t'i plotësojë këto kushte:

9.4 Të ketë sipërfaqe të mjaftueshme për mbledhje të mbeturinave;

9.5 Sipërfaqja të jetë e asfaltuar ose e betonuar;

9.6 Të ketë infrastrukturën tekniko-ndërtimore dhe objekte përcjellëse;

9.7 Të ketë zyrën e personelit për pranimin e mbeturinave;

9.8 Të ketë peshoren për matje, të mbeturinave;

9.9 Të ketë kontejnerë të mjaftueshëm për hedhjen të mbeturinave dhe

9.10 Të ketë objekte apo hapësira të tjera të mbuluara për manipulim me mbeturina.

Dorëzimi i mbeturinave të konstruktiv - demolimit

Neni 10

10.1 Gjatë procesit të ndërtimit, meremetimit apo demolimit të objekteve, personat duhet t'i largojnë nga hapësirat ose vendet publike mbeturinat që krijohen.

10.2 Mbeturinat e krijuara nga ndërtimet, meremetimet apo demolimet e objekteve në masën deri 0.1 m^3 , mund të hedhen në kontejnerë 5m^3 , të masës 4000 kg për mbeturina inerte, sipas paragrafit 6 të kësaj rregulloreje.

10.3 Dorëzimi i mbeturinave të krijuara nga ndërtimet, meremetimet apo demolimet e objekteve në masën mbi $1/10 \text{ m}^3$, është i rregulluar me Udhëzimin administrativ nr. 05/07, për mbeturinat nga konstruktimi dhe demolimi.

10.4 Transportimi i këtyre mbeturinave bëhet nga vetë prodhuesit ose ndërmarrjet për në pikat e mbledhjes së mbeturinave ose në vend- deponitë e caktuar nga Komuna.

Dorëzimi i mbeturinave brenda territorit të komunës

Neni 11

11.1 Të gjithë personat fizikë dhe juridikë që krijojnë mbeturina, kanë të drejtë të kenë qasje në shërbimet publike për hedhjen e mbeturinave.

11.2 Personat duhet të paguajnë për shërbimin e ofruar në bazë të tarifës së miratuar nga Komuna.

11.3 Krijuesi i mbeturinave detyrohet që mbeturinat t'i ndajë dhe t'i vendosë sipas sistemit të përcaktuar nga Komuna.

11.4 Amvisëritë dhe krijuesit tjerë të mbeturinave, obligohen që mbeturinat e tyre t'i hedhin në vende të caktuara për mbledhjen e mbeturinave, ndërsa mbeturinat e rrezikshme t'i ndajnë dhe t'i dorëzojnë në pikat mbledhëse apo në vendet e caktuara për të njëjtat.

Ndalesat

Neni 12

Sipas dispozitave të kësaj rregulloreje ndalohet:

12.1 Hedhja e mbeturinave ndërtimore në rrugë, trotuare, sheshet apo mjedise publike;

12.2 Hedhja e mbeturinave e llojeve tjera në kontejnerë ose në pikat mbledhëse të mbeturinave, të cilat nuk ndahen ashtu siç është paraparë;

12.3 Hedhja e mbeturinave në hapësirat e përbashkëta brenda dhe jashtë objekteve të banimit kolektiv (ballkonet, korridoret, tarracat e banesave etj.);

12.4 Hedhja e mbeturinave në rrugë, trotuare, sheshe apo në mjedise tjera publike;

12.5 Përzierja dhe hedhja e mbeturinave jashtë kontejnerëve të destinuar për ndarjen e mbeturinave të riciklueshme;

12.6 Hedhja e mbeturinave në rrugë nga automjetet në lëvizje;

12.7 Hedhja dhe deponimi i mbeturinave në hapësirat publike (në rrugë, parqe, dhe në vende të tjera publike);

12.8 Ndërrimi i vendndodhjes së kontejnerëve, pikave ose vendeve të betonuara për hedhjen e mbeturinave pa autorizim të autoriteteve komunale;

12.9 Djegia e mbeturinave në vende publike, kontejnerë, ose në pikat mbledhëse ose ndarëse të mbeturinave;

12.10 Shfrytëzimi i mbeturinave si ushqim për kafshët apo të ngjashme nga kontejnerët ose nga pikat mbledhëse të mbeturinave;

12.11 Shfrytëzimi i kontejnerëve publikë nga bizneset, veprimtaritë ekonomike për llojet e mbeturinave që nuk përfshihen në përkufizimin "mbeturina komunale dhe komerciale";

- 12.12 Gërmimi, përzierja, derdhja dhe përhapja e mbeturinave të hedhura në kontejnerë, ose në pikat mbledhëse nga personat e paaautorizuar;
- 12.13 Hedhja e mbeturinave jashtë kontejnerëve të mbeturinave;
- 12.14 Derdhja apo rrjedhja e mbeturinave prej automjeteve gjatë transportimit për në impiantet për trajtim apo për deponim në deponi të mbeturinave;
- 12.15 Personat duhet të marrin masa që gjatë transportimit të mbeturinave, automjetet e tyre të kenë mbulesë adekuate, me qëllim të pengimit të derdhjes, shpërndarjes apo rrjedhjes së mbeturinave gjatë transportit me destinacion tek impiantet për trajtim apo në deponi të mbeturinave;
- 12.16 Ndryshimi i mënyrës, metodave, teknikës dhe teknologjisë së largimit të mbeturinave në kundërshtim me kushtet e përcaktuar me kontratë apo ndonjë formë tjetër.
- 12.17 Mbeturinat nga pajisjet elektrike, elektronike dhe të vëllimshme nuk guxojnë të hedhen në kontejnerë të mbeturinave ose në afërsi të tyre.
- 12.18 Çdo ndryshim i kushteve nga paragrafi 13.8 i këtij neni, duhet të miratohet me shkrim nga organet kompetente komunale, duke marrë parasysh kushtet teknikohigjienike dhe të mjedisit.

Obligimi i krijuesve të mbeturinave komerciale

Neni 13

- 13.1 Krijuesit e mbeturinave komerciale, të regjistruar dhe të identifikuar nga Komuna, janë të obliguar ta informojnë Komunën-operatorin mbi sasinë e gjeneruar të mbeturinave dhe llojin e tyre.
- 13.2 Varësisht nga lloji i mbeturinave, krijuesi i mbeturinave komerciale obligohet në përmbushjen e kushteve të caktuara në bazë të marrëveshjes me operatorin, si pajisjet me kontejnerë adekuat për grumbullimin e llojeve të ndryshme të mbeturinave.

Përzgjedhja e operatorit

Neni 14

- 14.1 Operatori ekonomik që do të merret me grumbullimin dhe përpunimin e mbeturinave, zgjidhet me procedurë ligjore sipas LPP të Kosovës.
- 14.2 Personave që menaxhojnë mbeturinat, licenca iu lëshohet me dispozitat e nenit 55 të Ligjit për Mbeturina.

Ndërprerja e operimit për mbledhjen e mbeturinave

Neni 15

- 15.1 Ndërprerja e aktiviteteve të operatorit për mbledhjen e mbeturinave bëhet vetëm atëherë kur operatorin nuk iu përmbahet kushteve të përcaktuara me kontratë.
- 15.2 Para se të ndërpritet kontrata, Komuna e njofton me shkrim operatorin lidhur me shkeljen e bërë, jep vërejtjet, propozon masat dhe cakton afatin kohor për zbatim të kushteve të kontratës.
- 15.3 Me rastin e ndërprerjes së kontratës, operatorit i ndalohet aktiviteti për mbledhjen e mbeturinave.

Caktimi i tarifave dhe mënyra e arkëtimit

Neni 16

16.1 Komuna i cakton tarifat për mbeturinat, varësisht nga lloji i tyre, në bazë të Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale.

16.2 Mënyra e arkëtimit të tarifave të cekura në paragrafin 1. të këtij neni, do të rregullohet me vendim, të cilin do ta nxjerrë Kryetari i Komunës.

Raporti për menaxhimin e mbeturinave

Neni 17

17.1 Komuna duhet t'ia paraqesë Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor raportin vjetor për realizimin e planit lokal për menaxhimin e mbeturinave, deri më 31 mars të vitit vijues.

17.2 Raporti përmban të dhënat për llojin, përmbajtjen, karakteristikat, sasinë, organizimin, ruajtjen, transportimin, trajtimin, përpunimin, riciklimin, magazinimin dhe deponimin e mbeturinave, si dhe të mbeturinave të cilat pranohen në objektet dhe pajisjet për menaxhimin e mbeturinave.

Dispozitat ndëshkuese

Neni 18

Në rast të mosrespektimit të neneve të kësaj Rregulloreje, zbatohen masat ndëshkuese sipas dispozitave ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Dispozitat kalimtare dhe të fundit

Neni 19

Zbatimin e Rregullores e bëjnë Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit dhe Drejtoria e Inspeksionit.

Hyrja në fuqi

Neni 20

Rregullorja hyn në fuqi pas vlerësimit të ligjshmërisë përkatësisht regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në Web faqen zyrtare të Komunës.

Nr. 01-006-16407

Podujevë,

4 shkurt 2015

**Kryesuesi i Kuvendit**
Metmet Gashi